



RR E G U L L O R E

KOMUNALE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Nëntor 2020

Duke u bazuar në nenet 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në nenin 9 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020 aprovoi këtë:

RREGULLORE

KOMUNALE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Neni 1

- 1.1. Sipas kësaj Rregullore dhe në përputhje me Ligjin Nr.06/L-005, Tatimi në pronën e paluajtshme vendoset mbi të gjitha pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në territorin e Komunës së Shtimes, me përjashtim të pronave të paluajtshme të cilat lirohen nga tatimi në pronë në përputhje me nenin 10 të këtij Ligji.
- 1.2. Në përputhje me Nenin 9 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, do të fillon aplikimi edhe i Tatimit në Tokë.
- 1.3. Përshkallëzimi tatimor për Pronat e Paluajtshme, në Komunën e Shtimes, do të bëhet sipas normave tatimore për vitin 2021, si vijon:

Nr.	Përshkrimi i Pronës	Norma Tatimore
1	Pronat Rezidenciale	0.15%
2	Pronat e banuara	0.15%
3	Pronat komerciale	0.18%
4	Pronat industriale	0.15%
5	Pronat bujqësore	0.15%
6	Pronat e braktisura dhe objektet e pa banuara	0.15%
7	Pronat e papërfunduara	0.15%
8	Për njesitë bujqësore të parcelave	0.15%
9	Për njesitë pyjore te parcelave	0.15%
10	Për njesitë rezidenciale te parcelave	0.15%
11	Për njesitë komerciale te parcelave	0.15%
12	Për njesitë industriale te parcelave	0.15%

Neni 2

- 2.1. Vlera e pronës së paluajtshme përcaktohet në bazë të standardeve të parapara në Nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme si vijon: 1. Në bazë të vlerës së Kontratës për Shitblerje, 2. Të ardhurat që krijohen nga prona, 3. Shpenzimet e ndërtimit, 4. Madhësia dhe gjendja e pronës, 5. Si dhe vendi ku gjendet prona.

- 2.2. Ministria e Financave, përmes departamentit përkatës për tatimin në pronë, kryen vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, një herë në ç'do tri (3) vite, ose një herë në ç'do pesë (5) vite, bazuar mbi skemën përsëritëse si dhe procedurën e përcaktuar me aktin nënligjor që nxirret në përputhje me paragrafin (1) të nenit 17 Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
- 2.3. Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme i datës 26 janar 2018, dhe Udhëzimet Administrative i rregullojnë të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore.

Neni 3

Zbritja për vendbanimin parësor:

Neni 11 paragrafi një (1) i ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njesia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej pesëdhjet mijë (15.000) Euro nga vlera e vlerësuar e njesisë së objektit.

Neni 4

Pagimi i tatimit:

Për vitin tatimor 2021, tatimi dhe gjoba nëse ka të këtillë, paguhet në dy kështe të barabarta, deri më 30 Prill dhe më 30 Shtator të vitit tatimor.

Neni 5

Lirimi nga tatimi:

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronë, e të cilat janë të caktuara me nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Shtimes.

Neni 6

Shtyrja e tatimit:

Në bazë të nenit 24 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna mundet, në rrethana të veçanta të cilat do të shkaktonin vështirësi të mëdha për personin, të lejojë shtyrjen e afatit për pagesën e detyrimeve tatimore, në përputhje me paragrafet vijuese të këtijë neni.

Neni 7

Vjelja e detyruar e tatimit:

Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas kapitullit VII duke filluar nga neni 26 deri 30 të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove, në përputhje me paragrafet vijuese.

Neni 8

Gjobat:

- 8.1. Gjobat janë të parapara me nenin 35 paragrafet 1 deri në 7 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
- 8.2. Humbja e të drejtës mbi pronën do të bëhet në mbështetje dhe pajtim të plotë me Ligjin Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 9

Procedura ankimore:

E drejta e ankesës është e paraparë në kapitullin VIII (Mjetet Juridike) duke filluar nga neni 31 deri 33, të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/2019, për procedurat ankimore të tatimit ne prone.

Neni 10

Shfuqizimi:

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi – 01/354 Datë: 26.11.2019, për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020.

Neni 11

Hyrja në fuqi:

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes. Ndërkaq implementimi i saj do të fillojë nga data 01.01.2021.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj